




Gati për në shkollë

„Ndize jetën tënde dhe zgjedhi ata, të cilët i ofrohen zjarrit tënd“ (Rumi)



„Gati për në shkollë“ është një program/projekt gjuhësor i cili i'u dedikohet prindërve dhe fëmijeve të tyre që sapo kanë filluar shkollimin, poashtu ky program/projekt i'u dedikohet dhe është një mbështetje për institucione arsimore dhe organizatave të ndryshme. Prindërit marrin mbështetje prej një shoqërues të angazhuar, që ju ndihmon të bashkëpunojnë më fëmijet, që t'i zgjerojnë aftësitë e tyre në aspektin motorik, kognitiv dhe social. Përmes të këtij programi prindërit mësojnë se çka ka rëndësi për fëmijet kur kalojnë prej çerdhës në shkollë.

Qëllimet

- Përforsim në kompetencat edukativo arsimor, për prindërit që marrin pjesë
- Përforsim i marrëdhënieve mes prindit dhe fëmijes
- Mbështetje për përgaditjen e fillimit shkollor të suksesshëm
- Zgjerim i mundësive arsimore, për fëmijet që marrin pjesë
- Përforsim i shumëgjuhësisë
- Përforsim i vetëvlerësimit të prindërve dhe fëmijeve pjesëmarrës
- Rritje të kompetencave sociale dhe kulturore, të të gjithë pjesëmarrësve
- Përforsim/ Mbështetje të ndërsjellët për njëri-tjetrin në shoqërinë e përbashkët

Ofertë e programit

„Gati për në shkollë“ mbahet nga muaji tetor deri në qershor, një herë në javë nga dy orë mësimore (50 min. një orë mësimore). Ky program kryesisht mbahet në çerdhe, institucione dhe shoqata/organizata për mbështetje të prindërve – fëmijeve ose edhe në institucione të emigrantëve në tërë Austrinë. Kjo punë mbështetet nga prindërit dhe prej librit (Gati për në shkollë) e cila prindërve i'u ndihmon të gjejnë aktivitete të ndryshme për fëmijet e tyre. Ky projekt poashtu shërben si zgjerim i komunikimit mes çerdheve dhe fëmijeve.